



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 57 regjistër (JR)
Datë 20.12.2023

Nr. 90 i vendimit
Datë 10.12.2025

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Ina Rama	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 10.12.2025, ditën e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 57/2023 (JR), datë 20.12.2023, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Kujtim Bashaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 705, datë 18.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; nenet 63, 64, 65, 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet e ngritura në parashtrimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit Kujtim Bashaj, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 705, datë 18.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Kujtim Bashaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht: deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Në funksion të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.
4. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”)¹, në zbatim të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) ka mosdeklarime ndër vite; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
5. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”)², në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, i ka përcjellë Komisionit raportin e deklasifikuar plotësisht me vendimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” nr. {***}, datë 02.03.2021, në të cilin ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës.

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 16.01.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Kujtim Bashaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 03.03.2021.

6. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”)³ i ka përcjellë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Kujtim Bashaj.
7. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Kujtim Bashaj, për të tria kriteret.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

8. Komisioni, me vendimin nr. 705, datë 18.10.2023, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kujtim Bashaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës [...].*
9. Vendimi i Komisionit është bazuar në konkluzionet e arritura në lidhje me secilin kriter të rivlerësimit, si në vijim.
 - Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: [...] *Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Kujtim Bashaj nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk përmbush kriteret e nenit 33 të këtij ligji, për shkak se: (i) ka kryer deklarime të pasakta në përputhje me ligjin (shkronja “a” e pikës 5); (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit (shkronja “b” e pikës 5); (iii) nuk ka vërtetuar se nuk është në kushtet e parashikimit të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me mjetin në përdorim, në pronësi të motrës së tij K. B., përdorimin e të cilit e ka fshehur në deklaratën vetting; (iv) në mënyrë të përsëritur ka marrë kredi për të shlyer huatë dhe hua për të shlyer kreditë, me qëllim justifikimin e shlyerjes së tyre me të ardhura të ligjshme.*
 - Për kriterin e kontrollit të figurës: *Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Kujtim Bashaj ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të këtij ligji.*
 - Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Kujtim Bashaj ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit.*

III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit

10. Kundër vendimit të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, i cili ka kërkuar: (i) *Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes.* (ii) *Shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave, duke administruar prova të reja.* (iii) *Ndryshimin e vendimit nr. 705, datë 18.10.2023, të Komisionit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Kujtim Bashaj.*
11. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit i referohen vetëm kriterit të vlerësimit të pasurisë. Ankuesi ka pretenduar se vendimi i dhënë nga Komisioni, duke u bazuar vetëm në kriterin e

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 23.05.2023.

pasurisë, për shkarkimin e tij nga detyra, është kontradiktor, në kundërshtim me faktet e hetuara përgjatë procesit administrativ, si dhe me përcaktimet e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

12. Së bashku me ankimin, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa akte shkresore⁴, të cilat kërkoi të merreshin si provë e re në gjykim.
13. Në datën 04.12.2025, subjekti i rivlerësimit paraqiti pranë Kolegjit parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ankimit.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

14. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kujtim Bashaj, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

15. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

16. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji

⁴ Vërtetim njësie me origjinalin nr. {***} rep., datë 08.12.2023, bashkëlidhur të cilit gjenden 21 kontrata shitblerjesh të pasurive të paluajtshme për periudhën 2007-2009, deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.01.2006, leje ndërtimi me nr. {***} prot., datë 16.12.2004, si dhe akt kolaudimi (118 fletë); vërtetim njësie me origjinalin nr. {***} rep., datë 08.12.2023, bashkëlidhur të cilit gjenden një kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.11.2000; kontratë qiraje e datës 10.12.1999, si dhe vërtetim nga Banka OTP, datë 05.10.2023 (17 fletë); shkresë e Njesisë Administrative Nr. {***}, Tiranë me nr. {***} prot., datë 04.12.2023 (12 fletë); shkresë e Njesisë Administrative {***}, Tropojë, me nr. {***} prot., datë 07.12.2023 (12 fletë).

nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 705, datë 18.10.2023, të Komisionit, bazuar në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

17. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja bashkëlidhur ankimit, trupi gjykues vendosi të refuzojë kërkesën e subjektit për marrjen e tyre, pasi, nga analiza e kryer në kuadër të parashikimeve të nenit 47, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012, në konsideratë edhe të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronjat “a”, “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, u arrit në përfundimin se ato nuk plotësonin kërkesat e dispozitave procedurale të sipërcituara për pranueshmërinë e tyre si prova të reja në proces.
18. Në vijim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, në praninë e tij, si dhe kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nëpërmjet dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që do të kërkonin korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, nëpërmjet zhvillimit të gjykimit në seancë gjyqësore publike me praninë e ankuesit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të mos pranojë kërkesën për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe të vijojë shqyrtimin e saj në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit nga Komisioni dhe vlerësimi i trupit gjykues

19. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka arritur në përfundime të pavërteta duke zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi, për aplikimin e kësaj dispozite, sipas tij, kërkohet plotësimi në mënyrë kumulative i dy kriterëve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë. Sipas subjektit, mungesa e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, referuar nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, mund të përbëjë deklaram të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3, vetëm nëse shkelja është në nivel të krahasueshëm ose të njëjtë me fshehjen e pasurisë, deklaramin e rremë ose situatën e konfliktit të interesit – parashikuar respektivisht nga shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
20. Në përgjigje të këtij shkak ankimi, trupi gjykues, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se deklarami i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe deklarami i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, nuk duhet të interpretohen në mënyrë kumulative. Sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, referuar ligjit nr. 84/2016, duke sjellë si pasojë dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit dhe interpretimi kumulativ mbi të cilin mbështetet ky shkak ankimi, është i pabazuar pasi bie ndesh jo vetëm me parashikimet e dispozitave që rregullojnë deklaramin e pamjaftueshëm në Aneksin e Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, por edhe me frymën e procesit të rivlerësimit.
21. Subjekti ka pretenduar se Komisioni ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit, si një prej aspekteve të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, pjesë e të drejtave themelore kushtetuese

të subjektit, pasi nuk ka arsyetuar shkaqet mbi të cilat i bazon konkluzionet e tij, duke shkelur edhe nenin 57, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Lidhur me këtë pretendim, subjekti ka argumentuar se Komisioni nuk ka marrë në analizë të plotë gjithë rrethanat e faktit e të ligjit. Arsyetimi i vendimit, sipas subjektit, përmban haptazi zbatim të pasaktë e të gabuar të ligjit, që shfaqet në formën e abstragimit faktik e ligjor apo edhe në formën e argumenteve alogjike, duke e ngarkuar me përgjegjësi për faktin se ka kryer shlyerje të huave nëpërmjet kredive, të cilat Komisioni i konsideron të shpeshta dhe të dyshimta.

22. Në analizë të pretendimit të subjektit lidhur me arsyetimin e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka ilustruar pretendimin me pjesë të arsyetimit të vendimit që, sipas tij, janë alogjike apo që vijnë në kundërshtim me kërkesat e nenit 57 të ligjit nr. 84/2016 të referuar prej tij.
23. Nga analiza e vendimit objekt shqyrtimi, sa i takon aspektit formal, trupi gjykues konstatoi se, referuar përcaktimeve të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se teksti përmban të gjitha elementet e përcaktuara nga kjo dispozitë, si dhe rezulton në përputhje edhe me udhëzimet e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese⁵, pra i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje⁶. Ndërsa, sa i takon arsyetimit të vendimit, trupi gjykues vlerëson se ai lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrethanat e faktit të çështjes konkrete dhe natyrën e saj⁷. Nga analizimi i arsyetimit të vendimit objekt ankimi, vërehet se Komisioni ka referuar provat e marra në shqyrtim dhe i ka vlerësuar ato në funksion të vendimmarrjes. Ndërsa, për sa i përket pretendimit të subjektit lidhur me mënyrën se si Komisioni ka interpretuar veprimet juridike të tij (huatë dhe kreditë), trupi gjykues konstatoi se ky pretendim lidhet me vlerësimin në themel të kriterit të pasurisë dhe do të analizohet në vijim, së bashku me shkaqet e ankimit për këtë kriter.

C. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimi i trupit gjykues

24. Lidhur me pasurinë e llojit apartament 3+1, me sipërfaqe 131 m², të ndodhur në Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se: *subjekti nuk ka plotësuar kriteret e parashikuara në pikat 1 dhe 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në shkronjat “a” dhe “b” të nenit 33 të ligjit ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme në lidhje me këtë pasuri.*
25. Komisioni e ka bazuar vlerësimin për këtë pasuri në konstatimet se:
 - Bazuar në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit rezultoi me balancë negative në vlerën prej (-) 2.259.547 lekësh, për krijimin e kësaj pasurie.
 - Çmim i apartamentit objekt verifikimi, me të gjitha pjesët e tij përbërëse, është konsideruar shuma 67.069 euro, paguar në vitin 2005, sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.08.2005.

⁵ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 20, datë 13.04.2012.

⁶ Shijelluar në vendimin nr. 28, datë 15.05.2014, të Gjykatës Kushtetuese.

⁷ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 25, datë 10.06.2011 dhe nr. 3, datë 19.02.2013.

- Komisioni nuk ka konsideruar si burim të ligjshëm për blerjen e pasurisë objekt kontrolli, huanë e marrë nga shtetasi S. N., në gusht 2005, në shumën 2.000.000 lekë, pasi nuk u provua burimi i të ardhurave të huadhënësit.
- Komisioni nuk ka konsideruar si burim financiar të ligjshëm huanë e shtetases I. F. në muajin janar të vitit 2004, për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 500.000 lekë gjatë vitit 2004, nga të cilat subjekti pretendon se ka përdorur shumën 290.000 lekë për pagimin e një pjese të çmimit të apartamentit.

26. Subjekti i rivlerësimit e ka bazuar shkakun e ankimit në pretendimet si më poshtë.

- Çmimi i paguar prej tij për blerjen e apartamentit është 52.440 euro, sipas përcaktimit në kontratën e shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.01.2007, dhe jo ai i konsideruar nga Komisioni në analizën financiare, në shumën 67.069 euro, pasi kostoja e ndërtimit në momentin e lidhjes së kontratës, ka rezultuar më e ulët se ajo e menduar në vitin 2005, si për subjektin, ashtu edhe për të gjithë blerësit e tjerë në këtë godinë. Në ndryshimin e çmimit, ka ndikuar edhe ndryshimi i sipërfaqes së apartamentit nga 142,7 m² në 131,1 m².
- Lidhur me huanë në shumën 2.000.000 lekë, marrë nga z. S. N., subjekti ka pretenduar se ajo është deklaruar saktësisht prej tij në DIPP-në e vitit 2005. Pavarësisht përpjekjeve maksimale të ankuesit për të siguruar informacion, ai gjendet në pamundësi objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të huadhënësit, pasi ai ka ndërruar jetë dhe, nga momenti i dhënies së huasë, kanë kaluar rreth 18 vite, si dhe për shkak të mungesës së informacionit pranë organeve kompetente, të ngarkuara nga ligji për administrimin e tij. Sipas subjektit, detyrimi për dokumentimin e pagesave, bie mbi subjektet tregtare dhe jo mbi ankuesin. Fakti që z. N., sipas organeve tatimore, ka rezultuar me fitim nga aktiviteti tregtar i ushtruar, sipas subjektit, dëshmon se ai ka pasur mundësi financiare për dhënien e huasë. Mungesa e informacionit apo dokumentacionit në institucionet shtetërore nuk mund të deduktojë pavërtetësi për deklaratën e të ndjerit S. N..
- Lidhur me huanë e shtetases I. F., të pretenduar si të marrë në muajin janar të vitit 2004, në shumën 10.000 USD, ankuesi pretendon se ajo ka qenë me burime të ligjshme dhe duhet të përfshihet në analizën financiare të vitit 2004, si rrjedhojë analiza e këtij viti do të rezultonte pozitive. Subjekti ka pretenduar se moskonsiderimi i kësaj huaje në analizën financiare të kryer nga Komisioni, ka ndikuar gjendjen *cash* të deklaruar prej tij në vitin 2004 në shumën 500.000 lekë, nga e cila 290.000 lekë janë përdorur si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament 3+1, me sipërfaqe 131 m².

27. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit, në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstatoi si vijon.

- Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Apartament banimi 3+1, me sipërfaqe 131 m², porositur me kontratën (deklaratë noteriale) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.08.2005 [...]. Apartamenti është blerë në shumën 52.440 euro, i përlllogaritur në kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme (apartament) nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 08.01.2007. Në bashkëpronësi të familjes, në pjesë të barabartë. Vlera e deklaruar është 52.440 euro. Po në këtë deklaratë, si burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: (i) shitjen e*

apartamentit me sip. 70 m² datë 30.08.2005, në vlerën 4.000.000 lekë; (ii) kredi bankare në Raiffeisen Bank, në vlerën 2.000.000 lekë, disbursuar më datë 19.08.2005; (iii) hua në shumën 2.000.000 lekë, marrë z. S. N., pa akt shkresor, në mirëbesim.

- Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: *apartament banimi me sip. 142,7 m², ende i pahipotekuar, vlera 67.069 euro dhe pjesa takuese 50%.*
- Në DIPP-në e vitit 2006, dorëzuar më 27.03.2007, subjekti ka deklaruar se: *apartamenti i deklaruar vitin e kaluar, tani është me hipotekë nr. 77 dhe sipërfaqe 131,1 m².*
- Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti, në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, ka deklaruar se nuk ka ndryshim.

28. Gjithashtu, trupi gjykues konstatoi se subjekti ka nënshkruar deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.08.2005, me shoqërinë “{***}” ShPK, përfaqësuar nga z. Xh. H., për porositjen e një apartamenti me sipërfaqe ndërtimi 142,7 m² (përfshirë muret, shkallët, ballkonet, ambientet e tjera dhe çmimi ishte përcaktuar në vlerën 470 euro/m²), të ndodhur në katin e dytë të pallatit që po ndërtonte kjo shoqëri. Afati i përfundimit të objektit ishte parashikuar deri më datë 30.09.2005. Ndërsa, në lidhje me likuidimin e çmimit, përcaktohej se: *Me nënshkrimin e kësaj kontrate, janë bërë likuidimet e plota.*
29. Në vijim, në datën 08.01.2007, është nënshkruar kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., sipas së cilës shoqëria “{***}” ShPK i shet subjektit një apartament me sipërfaqe prej 131,1 m², me çmim 400 euro/m², në total 52.440 euro, shumë e cila është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.
30. Në përgjigje të pyetësorit standard të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se: *Kontrata e blerjes së këtij apartamenti me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.01.2007 (bashkëlidhur), është bërë në momentin e hipotekimit të objektit dhe, pas përmbylljes së punimeve dhe kolaudit të tyre, ka rezultuar me një sipërfaqe prej 131,1 m², me një çmim të negociuar përfundimisht në vlerën 52.440 euro. Vlerë kjo tashmë e shlyer plotësisht në vitin 2005, që lë një diferencë prej 14.629 eurosh. Kjo diferencë vlere ka qenë negociuar për të paguar më tej garazhet në të njëjtën ndërtesë.*
31. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se, me kërkesën e tij, ndërtuesi ka bashkuar dy hyrje në një, me sipërfaqe totale 142,7 m², sikurse pasqyrohet në deklaratën me të cilën është blerë ky apartament në vitin 2005. Në përfundim të ndërtimit të objektit, sipërfaqja e apartamentit ka rezultuar e reduktuar në 131,1 m², sikurse pasqyrohet në kontratën e shitjes së datës 08.01.2007. Po kështu, edhe kostoja përfundimtare e ndërtimit ka rezultuar më e ulët e, për rrjedhojë, edhe çmimi i paguar nga të gjithë blerësit në godinë, ka qenë më i ulët se ai i paguar nga subjekti në vitin 2005. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka paraqitur: (i) 16 kontrata të shitblerjes të apartamenteve dhe 5 kontrata të shitblerjes së garazheve në këtë pallat; (ii) deklaratën noteriale, datë 25.07.2023, të investitorit Xh. H., ku referohet se, në përfundim të ndërtimit, do të përshtateshin dy hyrje (1+1) në një, duke realizuar një hyrje 3+1, me sipërfaqe nga 142,7 m² në 131,1 m²; (iii) lejen e ndërtimit të objektit dhe planimetrinë e katit; (iv) aktin e kolaudit të dorëzuar në ZRVPP, ku citohet se punimet për ndërtimin e apartamentit me sipërfaqe të shfrytëzueshme përfundimtare prej 131,1 m², sipërfaqe të përbashkët prej 8,6 m² dhe sipërfaqe totale prej 139,7 m², kanë përfunduar më 31.07.2005.

32. Referuar aktit të kolaudimit të pallatit në të cilin ndodhet apartamenti i porositur nga subjekti, nuk rezultoi asnjë apartament me sip. 142,7 m² (përfshirë muret, shkallët, ballkonet dhe ambientet e tjera) në katin e dytë të pallatit, sikurse përcaktohej në deklaratën e vitit 2005, por evidentohet një apartament me sip. 131,1 m².
33. Subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të datës 25.07.2023, të shtetasit Xh. H., me anë të së cilës synon të provojë ndryshimin e sipërfaqes së apartamentit, si dhe ndryshimin e çmimit të paguar për blerjen e apartamentit, si pasojë e uljes së kostos së ndërtimit nga viti 2005 në vitin 2007 kur është finalizuar shitja e kësaj pasurie.
34. Lidhur me pretendimin e subjektit se, me diferencën e krijuar ndërmjet çmimit të paguar në vitin 2005 dhe çmimit të përcaktuar në kontratën përfundimtare në vitin 2007, me të cilën janë mbuluar çmimet për blerjen e dy garazheve në vitet 2007 dhe 2008. në shumën totale prej 7.488 eurosh, trupi gjykues vëren sa vijon.
35. Marrëdhënia juridike e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme në analizë, është krijuar me deklaratën e vitit 2005 dhe është finalizuar me kontratën e shitjes së vitit 2007, e nënshkruar pas përfundimit të punimeve dhe evidentimit të sipërfaqes reale të pasurisë. Nga përmbajta e këtyre akteve, vërehet se ka ndryshuar jo vetëm sipërfaqja e pasurisë, nga 142,7 m² në 131,1 m², por edhe çmimi, nga 470 euro/m² në 400 euro /m², duke sjellë reduktimin e çmimit total nga 67.069 euro në 52.440 euro.
36. Kontratat e shitblerjes të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, provojnë se çmimi i paguar në vitin 2007 nga banorët e tjerë të godinës ku ndodhet apartamenti i subjektit, ka qenë i njëjtë me atë të përcaktuar në kontratën e nënshkruar nga subjekti.
37. Rezulton se, sipas deklaratës noteriale të vitit 2005, në të cilën specifikohet se detyrimi është likuiduar plotësisht me nënshkrimin e kësaj deklarate, subjekti ka paguar 14.629 euro më tepër, nga çmimi i dakordësuar në kontratën e vitit 2007.
38. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues e vlerësoi të besueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, për blerjen e apartamentit në vitin 2007, çmimi i paguar prej tij ka qenë në shumën 52.440 euro dhe se diferenca e krijuar ndërmjet shumës së paguar në vitin 2005 dhe çmimit të paguar në vitin 2007, është konsideruar nga pala shitëse si pagesë e çmimit të blerjes së dy garazheve në vitet 2007 dhe 2008, në shumën totale prej 7.488 eurosh.
39. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, për efekt të analizës financiare, si vlerë e paguar për blerjen e apartamentit në vitin 2005, duhet të konsiderohet shuma prej 67.069 eurosh, pasi kjo është vlera që rezulton e likuiduar sipas deklaratës noteriale të këtij viti, mbi të cilën është bazuar marrëdhënia juridike ndërmjet palëve në momentin e kryerjes së pagesës dhe, si rrjedhojë, me të drejtë Komisioni ka kontrolluar burimet financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit në datën 31.08.2005, pavarësisht nga pretendimi i subjektit se në kontratën e vitit 2007, çmimi i paguar në vitin 2005 është reduktuar.
 - *Lidhur me burimet financiare të pagesës së kryer në datën 31.08.2005, për blerjen e apartamentit:*
40. Nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit lidhur me burimet e krijimit të pasurisë apartament, u konstatua si vijon.

41. Në deklaratën *vetting*, si dhe në shpjegimet e dhëna në vitin 2016 pranë ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar si burim: (i) shitjen e apartamentit 2+1, me sip. 70 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.8.2005, në vlerën 4.000.000 lekë, si burim krijimi për të cilin kishte shërbyer kredia e marrë në Bankën Amerikane në shumën 12.000 USD, në datën 12.05.2001 dhe likuiduar në vitin 2004; (ii) kredinë bankare në Raiffeisen Bank, në shumën 2.000.000 lekë, disbursuar në datën 19.08.2005; (iii) huanë në shumën 2.000.000 lekë, marrë shtetasit S. N. pa akt shkresor dhe pa interes.
42. Në DIPP-të e viteve 2005, 2006 dhe 2007, subjekti nuk e ka deklaruar burimin e pasurisë.
43. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: *Për shlyerjen e kësaj vlere, janë përdorur vlerat monetare të krijuara: nga shitja e apartamentit 2+1 në rrugën {***}, me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.08.2005 (bashkëlidhur), në vlerën 4.000.000 lekë; nga kredia në Raiffeisen Bank, e disbursuar në datën 19 gusht në vlerën 1.970.000 lekë; nga huaja e marrë nga z. S. N. në vlerën 2.000.000 lekë; dhe pjesa tjetër e plotësuar nga kursimet e vitit paraardhës.*
44. Të ardhurat në shumën 4.000.000 lekë, nga shitja e apartamentit me sip. 70 m² në datën 30.08.2005, si dhe kredia e marrë në Raiffeisen Bank, në vlerën 2.000.000 lekë, disbursuar më datë 19.8.2005, janë konsideruar nga Komisioni si burime për blerjen e apartamentit dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur pretendime në ankimin e paraqitur në Kolegj.
45. *Në lidhje me huanë në shumën 2.000.000 lekë nga S. N., Komisioni ka vlerësuar se: në kushtet kur: (i) nuk u vërtetua marrja e huasë nëpërmjet një akti shkresor në kohë reale; (ii) nuk u vërtetua shpërndarje dividendi nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “{***}” ShPK, ndërkohë që nga të dhënat bankare nuk vërehen llogari bankare/transaksione si në emër të shoqërisë, ashtu edhe në emër të administratorit të saj (të dhëna të tilla figurojnë vetëm për periudhën pas vitit 2005 e në vijim); (iii) për shlyerjen pjesore të huasë, subjekti ka marrë dhe ka përdorur një kredi në vitin 2007, një veprim ky jo vetëm i pajustificuar financiarisht (pasi huaja ka qenë pa interes, ndërsa kredia me interes), por edhe i përsëritur nga ana e subjektit, Komisioni vlerësoi që subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës sipas nenit 32/3 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me huanë e marrë nga shtetasi S. N.. Për rrjedhojë, huaja nuk është konsideruar si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë objekt verifikimi.*
46. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se këtë hua e ka deklaruar saktësisht në DIPP-në e vitit 2005 dhe në deklaratën *vetting*. Subjekti pretendon gjithashtu se ndodhet në pamundësi objektive, në kuptim të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, për të siguruar informacion të plotë mbi burimin e këtyre të ardhurave të dhëna hua, pasi marrëdhënia juridike i përket një periudhe prej gati 18 vitesh më parë dhe huadhënësi tashmë nuk jeton. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se organet kompetente, të ngarkuara nga ligji për verifikimin e burimeve të të ardhurave, janë shprehur se ekziston mungesë informacioni në institucionet shtetërore, por kjo nuk mund të interpretohet si pavërtetësi e deklaratës së të ndjerit S. N.. Sipas subjektit, fakti që nga aktiviteti tregtar i ushtruar, huadhënësi ka rezultuar me fitim, përbën një tregues të mundësive reale financiare të tij për të dhënë shumën e deklaruar si hua.
47. Nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me huanë në analizë, rezultoi si vijon.

48. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar hua në shumën 2.000.000 lekë, nga z. S. N., pa akt shkresor dhe pa interes. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2017, me anë të së cilës z. S. N. ka deklaruar se në gusht 2005, i ka dhënë hua subjektit shumën 2.000.000 lekë, pa interes dhe pa dokumente, ndërsa burimi i të ardhurave ka qenë biznesi i tij në fushën e ndërtimeve. Në të njëjtën deklaratë, huadhënësi ka konfirmuar se kjo shumë është shlyer në dy këste, ku kësti i fundit, në vlerën 1.000.000 lekë, është kthyer në vitin 2007.
49. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar hua në vlerën 2.000.000 lekë, të marrë në muajin gusht 2005, nga z. S. N. në mirëbesim, pa akt të shkruar. Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar shlyerjen e vlerës 1.000.000 lekë nga huaja, si dhe detyrimin e mbetur prej 1.000.000 lekësh. Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar shlyerjen e pjesës së mbetur të huasë, në shumën 1.000.000 lekë, përmes kredisë së marrë në mars të vitit 2007 në vlerën 4.000.000 lekë.
50. Nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, nuk u konstatua dokumentacion justifikues i kohës, për të provuar marrëdhënien e huasë së subjektit me z. N.. Dokumenti i vetëm që mbështet pretendimin e subjektit, është deklarata noteriale e huadhënësit S. N. e datës 20.01.2017, në të cilën i ndjeri S. N. ka deklaruar se në muajin gusht të vitit 2005, i ka dhënë borxh subjektit të rivlerësimit shumën 2.000.000 lekë.
51. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, për të provuar të ardhurat e ligjshme të huadhënësit S. N., subjekti ka paraqitur: (i) formularë deklarimi TVSh, TAP dhe kontribute sigurime shoqërore dhe shëndetësore për shoqërinë “{***}” ShPK, në periudhën 2004 - janar 2005; (ii) deklarime të z. S. N. ndaj degës së Tatim Taksave Kurbin për periudhën 2004-2005, për shoqërinë “{***}” ShPK.
52. Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, sipas informacionit të përcjellë nga DRT Lezhë⁸, si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare në internet të Qendrës Kombëtare të Biznesit (në vijim “QKB”), konstatoi se z. S. N. rezulton i regjistruar me dy numra NIPT, konkretisht: (i) NIPT {***} shoqëria “{***}” ShPK, është regjistruar në datën 20.01.1997, përmes të cilit ka realizuar të ardhura dhe fitime, duke filluar nga viti 1999; dhe (ii) NIPT {***}, S. N. – person fizik, me objekt veprimtarie bar-restorant-hotel, është regjistruar në datën 06.03.2008, përmes të cilit ka realizuar të ardhura dhe fitim duke filluar nga viti 2014, pas dhënies së huasë. Në lidhje me shoqërinë “{***}” ShPK, nga dokumentacioni i bashkëngjitur ekstraktit të gjeneruar nga QKB-ja, rezultoi se, sipas vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë nr. {***}, datë 20.06.2005, është vendosur zmadhimi i kapitalit themeltar nëpërmjet përfshirjes së fitimeve të mbartura. Konkretisht, fitimeve të mbartura deri në vitin 2004, në shumën 3.641.022 lekë, u është shtuar fitimi i vitit ushtrimor 2004, në shumën 705.735 lekë, duke arritur shumën 4.346.757 lekë. Sipas informacionit të DRT-Lezhë dhe QKB-së, rezultoi se fitimet e periudhës deri në fund të vitit 2004, nuk ishin tërhequr në formë dividendi, por ishin rikapitalizuar, për rrjedhojë huadhënësi nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për dhënien e huasë në gusht të vitit 2005, me të ardhura nga biznesi.

⁸ Shkresa kthim përgjigjeje e Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT) Lezhë nr. {***} prot., datë 23.08.2017, në dosjen ILDKPKI-së.

53. Ndërsa, në lidhje me shoqërinë “{***}” ShPK, DRT-Lezhë ka bërë me dije se tatimpaguesi nuk ka detyrime të papaguara deri në datën e dërgimit të shkresës. Nga ana tjetër, ky institucion nuk përcolli të dhëna financiare të kësaj shoqërie (pasqyra financiare etj.). Po ashtu, në asnjë dokument nuk rezultoi numri identifikues i shoqërisë (NIPT) e, për rrjedhojë, nuk mund të gjenerohej informacioni në faqen zyrtare të QKB-së.
54. Trupi gjykues, në analizë të sa më sipër, vëren se, megjithëse nga aktiviteti tregtar z. N. ka gjeneruar fitime, këto të fundit janë riinvestuar për rritjen e kapitalit të subjektit tregtar në pronësi të tij dhe nuk rezultojnë të jenë shpërndarë në formën e dividendit. Gjithashtu, në mungesë të dokumentacionit mbi të ardhurat personale të z. N., nuk u arrit të provohet mundësia e tij për të krijuar me burime të ligjshme, shumën e dhënë hua subjektit. Për rrjedhojë, Komisioni, me të drejtë, nuk e ka konsideruar huanë në shumën 2.000.000 lekë, si burim i ligjshëm, në analizën financiare të kryer për pasurinë apartament 3+1, në Tiranë, për pagesën e kryer në datën 31.08.2005.
55. Përpos sa më sipër, në drejtim të verifikimit të ekzistencës së marrëdhënies së huasë, e cila pretendohet të jetë marrë *cash*, krahas deklaratimeve jo të plota të subjektit të rivlerësimit rreth saj, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, përveç deklaratës noteriale të vitit 2017, nuk rezultoi ndonjë gjurmë transaksioni ose ndonjë dokument që do të dëshmonte mbi lëvizjen e shumës së dhënë hua, me burim arkën e shoqërisë apo likuiditetet bankare të saj, pavarësisht nga disponueshmëria e shumave në llogaritë e shoqërisë. Në lidhje me deklaratën e paraqitur nga subjekti, trupi gjykues vëren se, referuar jurisprudencës së Kolegjit⁹, deklaratat noteriale të lëshuara gjatë procesit të rivlerësimit, si të vetme, të pambështetura nga prova të tjera, konsiderohen me vlerë të kufizuar provuese.
56. Në konkluzion të analizës së mësipërme, lidhur me huanë në vlerën prej 2.000.000 lekësh, si një ndër burimet e pagesës së kryer në vitin 2005 për pasurinë apartament, trupi gjykues konstaton se mundësia e huadhënësit për të krijuar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua subjektit, nuk u provua sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
57. Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë se subjekti: (i) nuk ka provuar me dokumentacion të kohës marrëdhënien e huasë; (ii) nuk ka provuar burimin e ligjshëm të huadhënësit për shumën 2.000.000 lekë – arrin në përfundimin se huaja e marrë nga subjekti i rivlerësimit, nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për kryerjen e pagesës në vitin 2005 për blerjen e apartamentit.
58. Lidhur me shumën prej 290.000 lekësh, të cilën subjekti pretendon se e ka përdorur nga gjendja *cash* e vitit 2004¹⁰, për likuidimin e çmimit të apartamentit, Komisioni ka arritur në

⁹ Për qëndrimet e mbajtura nga Kolegji, lidhur me vlerën e deklaratave noteriale të lëshuara gjatë procesit të rivlerësimit, referojuni në vendimet e Kolegjit: nr. 6/2018 (JR); nr. 7/2019 (JR); nr. 34/2019 (JR); nr. 2/2020 (JR); nr. 23/2020 (JR); nr. 24/2020 (JR); nr. 29/2020 (JR); nr. 33/2020 (JR); nr. 11/2021 (JR); nr. 12/2021 (JR); nr. 11/2022 (JR).

¹⁰ Subjekti ka pretenduar se, në pamundësi për të likuiduar këstet e kredisë së marrë për blerjen e apartamentit në vitin 2001, të cilat ishin rritur si pasojë e ndryshimit të kursit të dollarit, mori huanë prej 10.000 USD nga znj. I. F., për likuidimin e kësaj kredie, duke mos e formalizuar këtë veprim juridik, për shkak të marrëdhënies miqësore që subjekti kishte me këtë person dhe bashkëshortin e saj. Në vijim, të ardhurat nga shitja e apartamentit

përfundimin se: [...] subjekti nuk ka mundur të vërtetojë të kundërtën e konstatimit që i përket krijimit të kursimeve në shumën 500.000 lekë në vitin 2004, për shkak të mosmarrjes në konsideratë të huasë nga shtetasja I. F. në muajin janar 2004. Për rrjedhojë, kursimet në shumën 290.000 lekë nuk janë konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të rishikuar.

59. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka pretenduar se në rast se në analizën financiare të vitit 2004 do të merrej në konsideratë huaja e marrë nga znj. F., ai do të rezultonte me burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar për këtë vit.
60. Nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit, rezultoi:
- Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar si burime për blerjen e apartamentit: 4.000.000 lekë nga shitja e një apartamenti, 2.000.000 lekë nga një kredi dhe 2.000.000 lekë nga një hua e marrë nga z. S. N., në total 8.000.000 lekë. Siç rezulton, kjo shumë nuk mbulon tërësisht vlerën e paguar për apartamentin prej 8.259.547 lekësh¹¹, duke lënë të pambuluar një diferencë prej 259.547 lekësh.
 - Në DIPP-në e vitit 2004, vërehet se subjekti ka deklaruar kursime *cash* nga paga në shumën 500.000 lekë.
 - Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti nuk ka deklaruar shtesë/pakësim të gjendjes *cash*.
61. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se një pjesë e vlerës së blerjes është mbuluar me kursimet e vitit 2004. I pyetur për shumën e saktë të përdorur nga këto kursime, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se ajo ka qenë rreth 290.000 lekë.
62. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se një ndër burimet për blerjen e apartamentit¹² me sipërfaqe 70 m², në datën 23.02.2001, në vlerën 15.600 USD, ka qenë edhe kredia e marrë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në maj të vitit 2001 pranë Bankës Amerikane, në shumën 12.000 USD¹³. Më pas, në datën 23.01.2004, në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit pranë Bankës Amerikane, është depozituar prej saj shuma 9.904 USD, e cila është transferuar për shlyerjen totale të principalit të kredisë së disbursuar në maj të vitit 2001.
63. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me burimin e shumës 9.904 USD, të depozituar *cash* në bankën Intesa SanPaolo në datën 23.01.2004, subjekti ka deklaruar se shuma prej 10.000 USD i është dhënë hua bashkëshortes se tij nga znj. I. F.. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale nr. {***} prot., nr. {***} kol., datë 25.07.2023, të znj. I. F., e cila ka konfirmuar dhënien e shumës prej 10.000 USD bashkëshortes së subjektit,

me sip. 70 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, në vlerën 4.000.000 lekë, u përdorën si një ndër burimet e krijimit të pasurisë apartament banimi 3+1, në rrugën “{***}”.

¹¹ Konvertuar shuma 67.069 euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën 31.08.2005, kur është nënshkruar deklarata noteriale.

¹² Kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.02.2001, S. B. (b/sh e subjektit) ka blerë apartamentin me sip. 70 m², rruga “{***}”, me vlerë 15.600 USD, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale, e cila u regjistrua në emër të saj sipas vërtetimit hipotekor nr. {***}, datë 26.02.2001.

¹³ Shkresa kthim përgjigjeje e bankës Intesa Sanpaolo (ish-Banka Amerikane) nr. {***} prot., datë 09.03.2021.

e krijuar me të ardhura të përfituara nga shitja e një pasurie dhe qiraje, kanalizuar nëpërmjet sistemit bankar.

64. Pas njoftimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni, për të provuar disponibilitetin financiar të huadhënëses, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave, dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë e thjeshtë e datës 10.12.1999, lidhur mes "{***}" ShA dhe z. H. F., për dhënie me qira të një apartamenti 3+1 në rrugën "{***}", me afat 1 vit, kundrejt pagesës 900 USD në muaj dhe, në rastin e përtëritjes së kontratës në vitin e dytë, 1.100 USD në muaj; 2 mandate arkëtimi, për dy pagesa qiraje *cash* për muajt janar dhe shkurt 2000.

- Vërtetim nga OTP Bank i datës 05.10.2023, për disa pagesa të kryera në mënyrë bankare për muajt janar - korrik 2001. Konstatohen shtatë transaksione, secili në vlerën 1.100 euro, në periudhën janar - korrik 2001. Nuk rezulton që subjekti të ketë paraqitur prova që të tregojnë likuidimin e detyrimeve tatimore për këto të ardhura.

- Kontratë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.11.2000, për shitjen e një apartamenti 1+1 në vlerën 1.900.000 lekë.

65. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vëren se deklarimi i huasë së pretenduar si e marrë nga znj. I. F., është bërë për herë të parë gjatë procesit të hetimit administrativ, konkretisht në përgjigjet për pyetësin nr. 2, ku është pyetur nga Komisioni në lidhje me burimin e krijimit të shumës 9.904 USD, depozituar nga bashkëshortja në datën 23.01.2004. Kjo hua nuk është deklaruar nga subjekti as në "Deklaratën e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" në vitin 2004 dhe as në deklaratën *vetting*¹⁴. Gjithashtu, edhe në përgjigje të pyetësit standard, kur subjekti është pyetur nga Komisioni nëse ka marrë ndonjëherë hua, ai ka deklaruar vetëm huatë e marra nga z. S. N. dhe z. N. Ll., ndërsa huanë e pretenduar nga znj. I. F., nuk e ka deklaruar.

66. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 19.01.2016, i pyetur për burimin e krijimit të depozitimit të shumës prej 9.904 USD, subjekti ka deklaruar se: *Në lidhje me këtë depozitë, dua të sqaroj se kjo ka si burim të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes në vite, unë kam qenë prokuror kurse bashkëshortja mjeke në maternitet [...].*

67. Trupi gjykues vlerëson se deklarata noteriale e shtetasës I. F. e vitit 2023, e paharmonizuar me prova të tjera, nuk ka vlerë provuese.

68. Bazuar në sa më sipër analizuar, në kushtet kur deklarimi i huasë së marrë nga shtetasja I. F., është bërë për herë të parë gjatë procesit të hetimit administrativ, pasi kjo hua nuk është deklaruar as në deklaratat vjetore periodike të periudhës 2004 – 2007 si detyrim financiar, as në deklaratën *vetting*, as në përgjigje të pyetësit standard dhe as në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në vitin 2016, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit për mospërfshirjen e saj si e ardhur në analizën financiare të vitit 2004.

¹⁴ Në deklaratën *vetting*, ka deklaruar se kredia prej 12.000 USD e marrë në vitin 2001, është likuiduar në vitin 2004, pa burimin e të ardhurave të përdorura për shlyerjen e saj. Në DIPP-të e viteve 2003 dhe 2004, subjekti nuk ka bërë asnjë deklaram në lidhje me kredinë e marrë në vitin 2001 apo me shlyerjen e saj në vitin 2004.

69. Si rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, nga analiza financiare, kanë rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 845.660 lekë për vitin 2004. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 500.000 lekë, të deklaruara nga subjekti në deklaratën e interesave të pasurisë të vitit 2004, për të cilën pretendon se ka shërbyer si burim për pagesën e pjesës së çmimit prej 259.547 lekësh.
70. Pas analizimit të të gjitha burimeve të deklaruara nga subjekti e bashkëshortja e tij dhe kontrollit të analizës financiare të kryer nga Komisioni për pagimin e shumës 67.069 euro/8.259.547 lekë në datën 31.08.2005, kur është nënshkruar deklarata noteriale, rezultoi se konfirmohet balanca negative e konstatuar nga Komisioni, në vlerën (-) 2.259.547 lekë, duke u gjendur subjekti i rivlerësimit në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
71. Lidhur me pasuritë e paluajtshme të llojit “garazh”, me sipërfaqe 27,3 m² dhe 10,1 m², të ndodhura në Tiranë, Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] Në analizën financiare të viteve 2007 dhe 2008, të paraqitur nga subjekti në parashtrime, ai nuk ka pasqyruar shpenzime për të blerë pasuritë garazhe, por ka përlllogaritur si të ardhur diferencën prej 7.141 eurosh, e cila nuk është deklaruar në asnjë DPV, por që, sipas sqarimeve që ka dhënë në pyetësonin nr. 2, i janë kthyer nga shitësi i apartamentit me sip. 131,1 m² gjatë vitit 2007. Për shkak të deklarimit të kësaj shume si e ardhur vetëm gjatë procesit të rivlerësimit, ky pretendim nuk u mor në konsideratë. Bazuar në sa më sipër, subjekti nuk ka kundërshtuar barrën e provës në lidhje me dy pasuritë garazhe, për të cilat nuk ka plotësuar kriteret e parashikuara në pikën 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe, bazuar në shkronjat “a” dhe “b” të nenit 33 të ligjit, ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme në lidhje me këto dy pasuri.
72. Subjekti ka kundërshtuar si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me konstatimin për mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e garazheve, duke theksuar se, si burim, kishte shërbyer diferenca e çmimit të paguar në vitin 2005 për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 131,1 m² në Tiranë, në raport me çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes së vitit 2007.
73. Deklarimet e subjektit për dy pasuritë e paluajtshme të llojit “garazh”, paraqiten si vijon.
- Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: (i) garazh me sip. 27,3 m², zk. {***}, në rrugën “{***}”({***}), me nr. pasurie {***}, blerë me kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme (garazh) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.01.2007, në vlerën prej 5.460 eurosh, në bashkëpronësi të familjes në pjesë të barabartë; (ii) garazh me sip. 10,1 m², zk. {***}, në rrugën “{***}”({***}), me nr. pasurie {***}, blerë me kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme (garazh) nr. {***} rep. nr. {***} kol., datë 04.03.2008, në vlerën 2.028 euro, në bashkëpronësi të familjes në pjesë të barabartë. Subjekti ka deklaruar të njëjtat burime krijimi si për apartamentin me sip. 131,1 m².
 - Në DIPP-në e vitit 2006 (ndërsa kontrata është e vitit 2007), subjekti ka deklaruar blerjen e pasurisë “garazh” me sipërfaqe 27,3 m², në vlerën 5.460 euro, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.
 - Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar blerjen e pasurisë “garazh” me sipërfaqe 10,1 m², në vlerën 2.028 euro, për të cilin ka deklaruar si burim kursime familjare.

74. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka shpjeguar se shuma prej 14.629 eurosh, e zbritur nga pagesa e çmimit të apartamentit, kishte shërbyer si burim për likuidimin e çmimit të dy garazheve (kur faktikisht të dyja garazhet kanë kushtuar 7.488 euro).
75. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se: *Vlera e mbetur pas rakordimeve për shkak të diferencës në çmimin përfundimtar të shitjes, vlera prej 7.141 eurosh, më është kthyer pjesë-pjesë gjatë këtij viti, dhe e kam mbajtur si pjesë të kursimeve familjare, në momentin e llogaritjes/përfitimit të tyre e kam përdorur për ta depozituar në llogarinë bankare, për t'i përdorur më tej në vitin 2008, për mbështetjen e vajzës së madhe E. për vazhdimin e studimeve.*
76. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se, me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.01.2007, shoqëria “{***}” ShPK i ka shitur subjektit një garazh me sipërfaqe 27,3 m², me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë, kundrejt çmimit prej 5.460 eurosh. Pagesa e çmimit është deklaruar e shlyer plotësisht jashtë zyrës noteriale.
77. Me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.03.2008, e njëjta shoqëri “{***}” ShPK i ka shitur subjektit një garazh tjetër me sipërfaqe 10,1 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, me çmimin prej 2.028 eurosh. Edhe në këtë rast, pagesa është deklaruar e likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale.
78. Sikurse u analizua më sipër në këtë vendim, lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 131,1 m², trupi gjykues e gjeti të besueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit se çmimi i blerjes së pasurive “garazhe”, me sipërfaqe përkatësisht 27,3 m² dhe 10,1 m², në shumën totale prej 7.488 eurosh është likuiduar nga diferenca prej 14.629 eurosh, e rezultuar midis pagesës në shumën e 67.069 eurove të kryer në vitin 2005 dhe çmimit përfundimtar të shitjes së apartamentit në shumën prej 52.440 eurosh, sipas kontratës së shitjes, datë 08.01.2007.
79. *Lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së gjendjes cash në kuadër të analizës financiare për periudhën 2003-2016, Komisioni ka arritur në përfundimin se: Gjendja e likuiditeteve cash të konsiderohet sipas deklarimeve në DPV. Edhe sikur pretendimi i subjektit të merrej në konsideratë, kjo nuk do të kishte ndonjë efekt të qenësishëm në analizën financiare, pasi balanca negative e analizës financiare e periudhës 2004 - 2016 (pasqyruar në përfundim të hetimit administrativ për kriterin e pasurisë) do të ndryshonte nga (-) 6.711.323 lekë në (-) 6.386.237 lekë. Ndërkohë, për Komisionin, mbetet ende i paqartë destinacioni i shumës 1.400.000 lekë.*
80. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së gjendjes cash, duke pretenduar se deklarimet e tij janë pasojë e një keqkuptimi të mënyrës së deklaramit të likuiditeteve sipas ligjit. Subjekti ka parashtuar në ankim se: *Në të gjitha deklaratat periodike vjetore të miat, kam deklaruar lidhur me cash-in, për shkak të një keqkuptimi të ligjit, çdo vit gjendjen totale të tyre në fund të vitit, dhe jo vetëm pjesën e shtuar. Pra, çdo vit kam deklaruar sa ka qenë gjendja cash deri në 31 dhjetor, dhe jo si shtesë nga gjendja e mbetur e vitit të kaluar. Nëse vitin pasardhës nuk kam deklaruar asnjë sasi cash, do të thotë që vlera e vitit paraardhës është harxhuar në vitin pasardhës, duke rezultuar në vlerë 0 cash në fund të tij. Ky ka qenë një keqkuptim i imi i mënyrës sesi duhej të deklarohet cash-i. Shpjegoj se në atë*

kohë, në kuptim të ligjit për Deklarimin e Pasurive, unë si subjekt rivlerësimi, nuk e kam kuptuar se kam pasur detyrimin të deklaroj vetëm shtesat dhe pakësimet. Shpjegoj se ky keqkuptim nuk është i qëllimshëm dhe se shumë subjekte të tjera rivlerësimi e kanë kuptuar ligjin në të njëjtën mënyrë me mua.

81. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me gjendjen *cash* ndër vite, janë si në vijim:
- Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Gjendje cash 600.000 lekë. Krijuar deri më 31.12.2016, nga kursimet nga pagat e marra nga unë, bashkëshortja dhe vajza.*
 - Në DIPP-2003, nuk ka deklaruar gjendje *cash*.
 - Në DIPP-2004, ka deklaruar: *Kam kursyer nga rroga ime dhe e bashkëshortes 500.000 lekë, viti 2004.*
 - Në DIPP-të e viteve 2005, 2006 dhe 2008 nuk ka deklaruar gjendje *cash*.
 - Në DIPP-2007 në seksionin e ndryshimit të pasurive, ka deklaruar: *nuk ka ndryshime, ndërsa në seksionin “Të dhëna konfidenciale”, ka deklaruar: Nga kursimet në vite, kemi depozituar në emrin e bashkëshortes S. B., pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë 252.679 lekë, 4.000 \$, 4.332 euro.*
 - Në DIPP-2009, ka deklaruar: *Shtesë cash në banesë, nga paga, 200.000 lekë.*
 - Në DIPP-2010, ka deklaruar: *Shtesë e gjendjes cash në banesë për vitin 2010, të ardhura nga pagat, 400.000 lekë.*
 - Në DIPP-2011, ka deklaruar: *Shtuar gjendja cash në banesë për vitin, 300.000 lekë.*
 - Në DIPP-2012, nuk ka deklaruar gjendje *cash*.
 - Në DIPP-2013, ka deklaruar: *Shtuar gjendja për vitin 2013, kursime nga paga, 200.000 lekë.*
 - Në DIPP-2014, ka deklaruar: *Shtuar gjendja në cash gjatë vitit 2014. Kursime nga pagat, 200.000 lekë.*
 - Në DIPP-2015, ka deklaruar: *Shtuar gjendja në cash gjatë vitit 2014. Kursime nga pagat, 100.000 lekë.*
 - Në DIPP-2016, ka deklaruar: *Shtuar gjendja në cash gjatë vitit 2016 bashkë me vitet e tjera, Kursime dhe një pjesë e vlerës së kredisë së marrë më datë 13.05.2016, 600.000 lekë.*
 - Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së¹⁵ në datën 19.01.2016, subjektit i është kërkuar të saktësojë gjendjen *cash* që dispononte deri në datën 31.12.2014. Në përgjigje, subjekti ka sqaruar se: *Gjendja cash deri më datë 31.12.2014, ka qenë 400.000 lekë. Në vitet e mëparshme kam deklaruar kursimet e çdo viti, të cilat janë përdorur në vitin pasardhës për pushime vjetore.*
82. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit, në raport arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton dhe vlerëson si vijon.
83. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se në fund të vitit 2016, totali i gjendjes *cash* ka qenë 600.000 lekë, e krijuar nga të ardhurat nga pagat dhe kredia e marrë atë vit. Ndërsa, në lidhje me shumën prej 1.400.000 lekësh, e cila rezulton nga diferenca ndërmjet

¹⁵ *Procesverbali i mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 19.01.2016.*

shumës së *cash*-it të akumuluar deri në fund të vitit 2016 në vlerën 2.000.000 lekë dhe gjendjes *cash* të deklaruar nga subjekti për atë vit, në shumën 600.000 lekë, subjekti nuk ka dhënë shpjegime mbi destinacionin e përdorimit të saj.

84. Trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit lidhur me keqkuptimin mbi detyrimin për të deklaruar vetëm shtesat dhe pakësimet, dhe jo gjendjen totale të *cash*-it deri më 31 dhjetor, pasi bie ndesh me përcaktimet e nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i cili detyron subjektet të deklarojnë shtesat dhe pakësimet faktike të pasurisë. Trupi gjykues vëren se subjekti ka deklaruar shprehimisht “shtuar gjendja *cash*”, çka tregon se bëhet fjalë për shtesa vjetore të kursimeve dhe jo për një gjendje kumulative të mbartur nga vitet e mëparshme. Për këto arsye, ashtu si Komisioni, në analizën financiare është konsideruar gjendja *cash* sipas raportimeve periodike ndër vite, sipas të cilave përlllogaritet se në fund të vitit 2016, subjekti duhet të kishte 2.000.000 lekë gjendje *cash*.

➤ *Disa konstatime të tjera të Komisionit:*

85. Lidhur me përdorimin nga subjekti, të automjetit me targë {***}, në pronësi të motrës K. B., Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] edhe nëse prindërit së bashku me motrën do të kishin të ardhura të mjaftueshme për blerjen e mjetit, kjo nuk vërteton faktin që mjeti nuk është në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit, në rastin kur ka rrethana që ngrenë dyshime të arsyeshme në lidhje me këtë fakt, si dhe: [...] subjekti nuk ka deklaruar sipas ligjit në deklaratën vetting dhe as në pyetësorin standard përdorimin e mjetit – subjekti i rivlerësimit nuk ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës që nuk është në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke u përpyetur të fshehë pasurinë në përdorim në deklaratën vetting, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

86. Subjekti ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit lidhur me dyshimet për fshehje të pasurisë, me pretendimin se mosdeklarimi i përdorimit të mjetit në deklaratën vetting, përbën një pakujdesi që nuk mund të sjellë penalizimin e tij sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, pasi këtë automjet e ka përdorur vetëm për t'u ardhur në ndihmë familjarëve sa herë e kishin të nevojshme. Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka pretenduar se mjeti është blerë me kursimet e motrës, me burime të ligjshme dhe se Komisioni duhet të përfshinte në analizën financiare të ardhurat nga: (i) pensioni i prindërve ndër vite; (ii) të ardhurat e tyre nga shitja e një prone në vitin 2006, në shumën 600.000 lekë; (iii) të ardhurat në shumën 700.000 lekë në vitin 2004, si dhe 717.000 lekë në vitin 2007, të përfituara nga shitja e rakisë.

87. Sipas subjektit, mosdeklarimi i përdorimit të automjetit ka qenë një pakujdesi e paqëllimshme, lidhur me të cilën ai ka dhënë shpjegime pranë ILDKPKI-së në datën 19.01.2016, ku ka paraqitur edhe një prokurë të posaçme nr. {***} rep., {***} kol., datë 09.05.2013, pa afat, sipas së cilës shtetasja K. B. (motra e subjektit) i jep në përdorim subjektit mjetin me targë {***}.

88. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstatoi se me anë të kontratës¹⁶ së shitblerjes, znj. K. B., në datën 25.06.2010, ka blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, një automjet të tipit “{***}”, viti i prodhimit 2008, në vlerën 13.000 euro. Në kontratë, palët kanë deklaruar se janë likuiduar totalisht.
89. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar automjetin në përdorim as në deklaratën *vetting* (sipas autorizimit që dispononte), as në pyetësoin standard. Ndërkohë që, referuar nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, përcaktohet se subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin dhe ky deklaram, në kuptim të pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë një deklaram i saktë dhe i plotë i pasurive në pronësi dhe përdorim. Po ashtu, deklarata e pasurisë *vetting*, sipas shtojcës 2, miratuar me ligjin nr. 84/2016, përcakton detyrimin për deklarimin e pasurive në pronësi, posedim apo në përdorim.
90. Trupi gjykues konstatoi se, sipas të dhënave të sistemit TIMS, ishin regjistruar 114 hyrje - dalje të subjektit të rivlerësimit me automjetin me targë {***} në pronësi të motrës së tij, deri në vitin 2018, ndërkohë që, sipas TIMS-it, K. B. nuk e ka përdorur asnjëherë këtë mjet. Gjatë periudhës 2015-2017, motra e subjektit rezultonte përdoruese e mjetit me targë {***}, në pronësi të shtetasit F. I..
91. Komisioni, në arsyetimin e vendimit, ka konkluduar herë për fshehje pasurie, e herë për fshehje të “përdorimit” të automjetit, duke e bërë të paqartë qëndrimin e tij lidhur me këtë pasuri. Për një qëndrim garantist ndaj subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues e interpreton vlerësimin përfundimtar të Komisionit se lidhet vetëm me fshehjen e përdorimit të automjetit, duke mos e konsideruar atë si një pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit. Në këtë optikë, trupi gjykues i konsideroi pa peshë për zgjidhjen e çështjes, pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie nga motra e tij K. B..
92. Në përfundim, në lidhje me automjetin me targë {***}, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka fshehur përdorimin e tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke u gjendur, për rrjedhojë, në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.
93. *Në lidhje me vendbanimin e motrës së subjektit të rivlerësimit, Komisioni, në vendim, ka arritur në konkluzionin se: [...] Subjekti nuk paraqiti akte nga Zyra e Gjendjes Civile apo dokumente të tjera shkresore për të në lidhje me sa i është kërkuar nga Komisioni me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ. Në këto kushte, në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk është treguar bashkëpunues me qëllim qartësimin e situatës dhe heqjen e dyshimeve të Komisionit dhe, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ky fakt është mbajtur në konsideratë në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.*
94. Subjekti ka pretenduar në ankim se nuk ka qenë i qartë lidhur me dokumentacionin që duhet të dërgonte, për sa kohë as prindërit dhe motra nuk ishin persona të lidhur apo persona të tjerë të lidhur, por është qartësuar përmes vendimit të dhënë nga Komisioni. Subjekti ka shpjeguar se regjistrimi në Tiranë¹⁷, ishte bërë vetëm për efekt të studimeve, të cilat nuk u kryen nga motra,

¹⁶ Kontratë shitblerjeje e automjetit nr. {***} rep., {***} kol., datë 25.06.2010.

¹⁷ Me shkresën e datës 30.11.2023, subjekti ka kërkuar informacion në Zyrën e Gjendjes Civile pranë Njësisë Administrative Nr. {***}, Tiranë, e cila me shkresën e datës 04.12.2023, ka sqaruar se shtetasja K. B. ka ardhur

pasi prindërit u sëmurën dhe kishin nevojë për të. Po ashtu, subjekti ka paraqitur një vërtetim të datës 07.12.2023, nga Njësia Administrative {***}, Tropojë, në të cilin deklarohet se prindërit dhe motra nuk janë shpërngulur asnjëherë fizikisht nga fshati {***}. Ndërsa, në mars të vitit 2011, me kërkesë të z. K. B., janë zhvendosur nga Njësia Bashkiake Nr. {***}, Tiranë në Njësine Administrative {***}, Tropojë dhe znj. K. B., me regjistrimet e gjendjes civile, rezulton në Tiranë, por ajo jeton dhe punon në fshatin {***}, Tropojë, sikurse është vërtetuar gjatë hetimit të kryer nga Komisioni nëpërmjet vërtetimeve të punësimit nga viti 2003 e në vijim (administruar me pyetësorin nr. 4), si dhe referuar printimit të regjistrit të gjendjes civile të datës 18.09.2023, ku vërehet se znj. K. B. është në të njëjtën përbërje familjare me prindërit.

95. Trupi gjykues e gjen pa peshë konkluzionin e mësipërm të Komisionit, të kundërshtuar në ankim nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me dhënien e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra dhe, si rrjedhojë, për ekonomi gjyqësore, e konsideroi të pranuar pretendimin e ankuesit në lidhje me këtë shkak ankimi.

➤ *Lidhur me huanë e marrë nga shtetasi N. Ll. në vitin 2010:*

96. Komisioni ka arritur në përfundimin se: *Subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës sipas nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me huanë e marrë nga shtetasi N. Ll.. Për rrjedhojë, huaja e marrë nga ky shtetas nuk është konsideruar si burim krijimi i pasurisë objekt verifikimi në analizën financiare të rishikuar. Sa i takon pamundësisë financiare për shlyerjen e huasë, pavarësisht se pretendimet e subjektit në parashtrime nuk qëndrojnë, në përfundim të procesit, shumat e deklaruara për shlyerjen e pretenduar të huasë së marrë shtetasit N. Ll., në periudhën 2011 – 2016, në DPV-të e këtyre viteve, nuk u konsideruan si shpenzime në analizën financiare të këtyre viteve, për sa kohë huaja nuk u konsiderua si burim për blerjen e pasurisë.*
97. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se një ndër burimet për likuidimin e kredisë së marrë prej tij në vitin 2007, në Raiffeisen Bank, në shumën 4.000.000 lekë, ka qenë huaja e marrë nga shtetasi N. Ll. në vitin 2010, në shumën 2.500.000 lekë. Analizimi i këtij pretendimi merr peshë në drejtim të efektit në situatën financiare të subjektit në vitin 2010.
98. Subjekti ka parashtruar në ankim se ka deklaruar saktësisht huanë në DIPP-në e vitit 2010, konkretisht në seksionin "Të dhëna konfidenciale", paragrafi II, ku citohet: *Marrë hua nga shtetasi N. Ll. në datën 23.04.2010, në vlerën 2.500.000 lekë, për shlyerjen e kredisë në Raiffesen Bank, duke pretenduar se marrëdhënia e huasë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, mund të paraqitet edhe në formë të thjeshtë shkresore¹⁸. Po ashtu, subjekti ka pretenduar konsiderimin si të ligjshme të të ardhurave nga veprimtaria e tregtare e z. Ll. në shoqëritë tregtare "{***}" ShPK dhe "{***}" ShPK, duke theksuar se mospagimi i dividendit*

*si banore nga komuna {***}, Tropojë, më datë 20.04.2006, duke bashkëlidhur një kontratë për marrjen me qira të një apartamenti nga shtetasi Xh. H., në Tiranë, për periudhën 31.12.2005 - 31.12.2007.*

¹⁸ *Subjekti ka referuar vendimin nr. 20, datë 31.07.2019: "22. [...] Kolegji vlerëson se kontrata e huasë e formalizuar në formë shkresore të thjeshtë, është një formë e lejuar për të provuar ekzistencën e kësaj marrëdhënieje, në kuptim të dispozitave të Kodit Civil, respektivisht nenet 1050-1055, të cilat nuk parashikojnë për efekt të vlefshmërisë së saj një formë të caktuar shkresore, duke e përfshirë këtë veprim juridik te kontrata informale".*

nga këto shoqëri, është përgjegjësi e administratorit të tyre, z. N. Ll. e, për rrjedhojë, të ardhurat nga huaja duhet të konsiderohen të ligjshme e të përfshihen në analizën financiare të vitit 2010.

99. Deklarimet e subjektit në lidhje marrjen dhe likuidimin e huasë, paraqiten si vijojnë.
100. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Marrë hua shuma 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë shtetasit N. Ll., në vitin 2010, me deklaratë dore, me qëllimin që ta përdorja për të ulur këstin e kredisë së marrë në Raiffeisen Bank me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2007. Likuidimin e huasë shtetasit N. Ll. e kam bërë me këste vjetore, me kursimet nga paga ime dhe e kam përfunduar plotësisht në muajin dhjetor 2016, duke plotësuar këstin e fundit edhe me vlerën nga kredia që kam marrë më datë 13.05.2016, në Raiffeisen Bank (deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.01.2017, noteri P. B. B., Tiranë).*
101. Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar huanë prej 2.500.000 lekësh të marrë nga shtetasi N. Ll. më datë 23.4.2010, për shlyerjen e kredisë në Raiffeisen Bank.
102. Në pyetësin standard, subjekti ka paraqitur një fotokopje deklarate me shkrim dore të datës 23.04.2010 të z. N. Ll., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, i cili ka deklaruar se i ka dhënë hua z. K. B., shumën 2.500.000 lekë, pa interes, me afat kthimi 10 vite, për të likuiduar kredinë, para të cilat i ka tërhequr nga llogaria e tij personale, të siguruara nga paga e tij prej 500.000 lekësh në muaj, pa përmendur të ardhura nga ndonjë biznes privat. Po ashtu, në përgjigje të pyetësit standard, subjekti ka paraqitur kopje të një deklarate noteriale të datës 23.01.2017 të z. Ll., në të cilën konfirmohet dhënia e huasë në vitin 2010 dhe likuidimi total në vitin 2016, por nuk është shprehur për burimin e të ardhurave të huasë.
103. Në përgjigje të pyetësit nr. 2, subjekti ka paraqitur ekstraktin bankar nga Union Bank ShA, ku pasqyrohet tërheqja e shumës 4.000.000 lekë nga kjo llogari biznesi në datën 09.04.2010, nga shtetasi N. Ll., destinacioni i përdorimit të së cilës nuk mund të identifikohet. Për më tepër, huaja prej 2.500.000 lekësh nuk është deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin 2010 dhe as likuidimi i saj në vitet në vijim.
104. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti pranë Komisionit, lidhur me të ardhurat nga paga të z. N. Ll., ka rezultuar se në llogarinë e pagës së z. N. Ll. pranë Union Bank¹⁹, më datë 09.04.2010, janë kryer kreditimet e para të pagës nga shoqëria “{***}” ShPK. Gjatë muajit prill 2010, janë kryer pagesat e pagave për muajt shkurt dhe mars, në një shumë totale prej 881.946 lekësh. Kjo shumë është tërhequr *cash* në datat 30.04.2010 (600.000 lekë) dhe 07.05.2010 (280.000 lekë). Ndërsa, në llogarinë e tij pranë Raiffeisen Bank, në datën 13.04.2010 është kredituar një pagë në shumën 15.184 lekë, e cila është tërhequr në shuma të vogla në ditët në vijim.
105. Sa i takon shoqërisë “{***}” ShPK, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve²⁰ është bërë me dije se shoqëria rezulton me fitim për vitet 2009-2010, por nuk ka informacion në lidhje me shpërndarje dividendi. Referuar ekstraktit bankar të shoqërisë “{***}” ShPK²¹, në monedhën

¹⁹ Shkresa kthim përgjigjeje e Union Bank nr. {***} prot., datë 05.07.2023.

²⁰ Me shkresën nr. {***} prot., datë 23.06.2023.

²¹ Kopje e një pjese të ekstraktit të llogarisë bankare të “{***}” ShPK, pranë Union Bank (faqet 6 dhe 7), paraqitur nga subjekti me përgjigjet e pyetësit standard.

lekë, rezulton se më datë 09.04.2010, është kryer një tërheqje në shumën prej 4.000.000 lekësh, të cilën ai e ka referuar në ankim si burim për dhënien e huasë. Po ashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka dorëzuar ekstraktin bankar të së njëjtës shoqëri në monedhën euro, pranë Raiffeisen Bank, nga i cili rezulton se më datë 19.04.2010, është kryer një tërheqje në shumën prej 32.000 eurosh, së cilës ai gjithashtu i referohet në ankim si burim për dhënien e huasë.

106. Në lidhje me shoqërinë “{***}” ShPK, DRT-Lezhë²² ka informuar se, sipas pasqyrave financiare të depozituara nga shoqëria “{***}” ShPK, me NIPT {***}, për periudhën 2001-2010, shoqëria rezulton me fitim, por nuk ka informacion në lidhje me shpërndarje të dividendit.
107. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se shumatat e tërhequra nga N. Ll. nuk mund të konsiderohen si burim për dhënien e huasë, pasi ato janë tërhequr nga një llogari biznesi dhe nuk mund të përcaktohet destinacioni i përdorimit të tyre. Po ashtu, nga verifikimet e bëra në burime të hapura²³, në dokumentacionin bashkangjitur ekstraktit historik të shoqërisë, konstatohet se shoqëria ka rezultuar me fitime në vitet 2007 – 2009 dhe, sipas vendimeve të ortakut të vetëm, këto fitime janë kapitalizuar, pra nuk i janë shpërndarë ortakut, por janë përdorur për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë. Për rrjedhojë, nuk u vërtetuan të ardhura të përfituara nga z. N. Ll. nga shoqëria tregtare “{***}” ShPK.
108. Pagat e kredituara në llogarinë personale të huadhënësit, rezultojnë se janë përfituar pas momentit të dhënies së huasë dhe, për pasojë, ato nuk mund të kenë shërbyer si burim për dhënien hua të shumës prej 2.500.000 lekësh.
109. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të ardhurat e ligjshme të huadhënësit, si të ardhurat e tij personale, ashtu edhe ato të përfituara nga shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Pra, huaja e marrë nuk mund të konsiderohet si burim financiar i ligjshëm për shlyerjen pjesore të kredisë pranë Raiffeisen Bank. Për rrjedhojë, kjo shumë, me të drejtë, nuk është përfshirë nga Komisioni në analizën financiare të vitit 2010.

➤ *Lidhur me analizën financiare 2004 – 2016:*

110. Komisioni, pasi kreu analizën financiare për periudhën 2004 – 2016, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve në vlerën (-) 6.711.323 lekë. Sipas Komisionit: *edhe balanca negative e konfirmuar nga subjekti në analizën financiare të paraqitur prej tij, prej 1.725.043 lekësh, është penalizuese dhe në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, referuar standardit të konsoliduar të organeve të vlerësimit.*
111. Trupi gjykues, në analizën për vitet 2007 dhe 2008, nuk e ngarkoi subjektin e rivlerësimit me shpenzim për blerjen e dy garazheve, për arsyet e trajtuara më lart në këtë vendim, por nuk konsideroi si të ardhur shumën prej 7.141 eurosh, të cilën subjekti pretendon se i është kthyer nga shoqëria ndërtimore, pasi një fakt i tillë nuk gjen pasqyrim në asnjë provë dhe subjekti i

²² Shkresa kthim përgjigjeje e DRT Lezhë nr. {***} prot., datë 05.07.2023, në dosjen e Komisionit.

²³ Faqja zyrtare në internet e QKB-së.

rivlerësimin nuk ka përcaktuar as kohën konkrete të kthimit të saj. Nga sa më sipër, balanca e vitit 2007, ndryshon nga (-) 1.003.104 lekë e përlllogaritur nga Komisioni në (-) 342.935 lekë.

112. Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrolloi analizën financiare të Komisionit, nga e cila rezultoi se për periudhën 2004-2016, subjekti i rivlerësimin dhe personat e lidhur me të rezultuan me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve në vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2009, 2010 dhe 2014, për shumën totale prej (-) 6.051.155 lekësh, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
113. Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit, bazuar në konkluzionet e arsyetuara më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimin ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimin të pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, vendimi i Komisionit nr. 705, datë 18.10.2023, është i mbështetur në fakte e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 705, datë 18.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimin Kujtim Bashaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 10.12.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi